



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.Shk II.nr.100/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS- Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtaren Franciska Zhitija Ymeri në çështjen përmbartimore të kreditorit “F-Shped”, Sh.p.k, me seli në Prishtinë, lagja “...”, rruga “...”, p.nr, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit avokat L.M. nga Ferizaj, kundër debitorit “Enertech” Sh.p.k, me seli Prishtinë, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.1243/21, të datës 29.12.2021, me datë 22.06.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e kreditorit “F-Shped”, Sh.p.k, me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë -Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.1243/21, të datës 29.12.2021, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin e ankimuar PPP.nr.1243/21, të datës 29.12.2021, në pikën I të dispozitivit e ka pranuar në tërësi si të bazuar prapësimin e debitorit të përmbartimi “Enertech” Sh.p.k, me seli Prishtinë, ka shfuqizuar Urdhrin për Përmbartim P.nr.594/2021, të datës 17.09.2021, dhe është refuzuar i pabazuar propozimi për përmbartim i paraqitur me datë 17.09.2021 nga kreditori i përmbartimit “F-Shped”, Sh.p.k, me seli në Prishtinë, tek përmbartuesi privat Besnik H. Aliu.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, (*me pretendime sikur në ankesë*), me propozim, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të anulohet aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.1243/21, të datës 29.12.2021.

Ankesa e kreditorit i është dorëzuar debitorit për përgjigje me datë 14.02.2022, dhe i njëjti nuk ka parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “F-Shped”, Sh.p.k, me seli në Prishtinë, me datën 17.09.2021, ka paraqitur propozimin për përmbartim në bazë në bazë të dokumentit të besueshëm dhe atë faturave R66369 e datës 23.08.2021 në shumë prej 100 euro, R66331 e datës 23.08.2021 në shumë prej 100 euro, R66058 e datës 21.08.2021 në shumë prej 100 euro, R66053 e datës 21.08.2021 në shumë prej 100euro dhe R66481 e datës 23.08.2021 në shumë prej 130 euro, në shumën e përgjithshme prej 530€.

Përmbartuesi Besnik H Aliu, duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorit me urdhrin përmbartimor P.nr.594/2021, të datës 17.09.2021 e ka lejuar përmbartimin e propozuar nga kreditori, ndërsa debitori me brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim duke kundërshtuar faturën për faktin se nuk është pranuar nga debitori.

Përgjigje në prapësim ka ushtruar kreditori brenda afatit ligjor, duke theksuar se janë të pa bazuara pretendimet e debitorit në prapësim pasi që fatura i plotëson kushtet bazuar në nenin 29 të LPP-së, andaj ka kërkuar që të refuzohet si i pabazuar prapësimi i debitorit.

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit, ka nxjerrë aktvendimin e ankimuar me PPP.nr.1243/21, të datës 29.12.2021, në pikën I të dispozitivit e ka pranuar në tërësi si të bazuar

prapësimin e debitorit të përbarimi “Eneritech” Sh.p.k, me seli Prishtinë, ka shfuqizuar Urdhrin për Përbarim P.nr.594/2021, të datës 17.09.2021, dhe është refuzuar i pabazuar propozimi për përbarim i paraqitur me datë 17.09.2021 nga kreditori i përbarimit “F-Shped”, Sh.p.k, me seli në Prishtinë, tek përbaruesi privat Besnik H. Aliu. Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar gjykata ka theksuar se me shikim në shkresat e lëndës ka gjetur se fatura kontestuese nuk i plotëson kushtet e paraparë me nenin 29 par.3 të LPP-së. Ndër të tjera ka cek se debitori me asnjë provë nuk ka mundur t’i provoj faktin se faturat në fjalë i janë dorëzuar debitorit ngase të njëjtat nuk janë nënshkruar nga debitori, në mënyrë që debitori të ketë cilësinë e debitorit nga këto fatura, dhe se faturat nuk janë nënshkruar nga debitori e ky fakt nuk mund të argumentohet nga ana e kreditorit me asnjë provë tjetër përcjellëse.

Gjykata Komerciale Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata Komerciale dhoma e shkallë së dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i ankimuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të kujdeset dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë gjen se sipas shkresave të lëndës, pala kreditore propozimit të saj për përbarim i’ a ka bashkangjitur faturat R66369 e datës 23.08.2021 në shumë prej 100 euro, R66331 e datës 23.08.2021 në shumë prej 100 euro , R66058 e datës 21.08.2021 në shumë prej 100 euro, R66053 e datës 21.08.2021 në shumë prej 100euro dhe, R66481 e datës 23.08.2021 në shumë prej 130 euro, në shumën e përgjithshme prej 530€, e të cilat nuk janë nënshkruar as pranuar nga debitori, në rastin konkret fatura nuk paraqet bazë për të qenë dokumente të besueshëme pasi që nuk janë plotësuar kushtet nga neni 27 i LPP-së.

Gjykata e shkallës së parë drejtë ka vepruar kur ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit dhe ka shfuqizuar urdhrin për përbarim P.nr.594/2021, të datës 17.09.2021, duke vlerësuar se faturat nuk i plotësojnë kushtet sipas ligjit për të qenë dokument i besueshëm, pasi që të njëjtat nuk janë

të pranuar dhe nënshkuara nga debitori. Sipas dispozitës së nenit 29 paragrafi 3 të LPP-së, përcaktohet se: “*Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar*”, e po ashtu edhe me Udhëzimin Administrativ Nr.15/2010, për zbatimin e Ligjit mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat, përkatësisht në nenin 20, paragrafi 1.1.17, përcaktohet se: “*në minimum, një faturë duhet të jetë e nënshkuar nga shitësi, nëse klienti apo blerësi është në dispozicion për të nënshkuar, ai person duhet po ashtu të nënshkruaj faturën tatimore*”, andaj në rastin konkret gjykata me të drejt ka vlerësuar se faturat në bazë të cilave është lejuar përmbartimi nuk i plotësojnë kushtet për të qenë dokument i besueshëm sipas ligjit pasi që nuk janë të pranuar dhe nënshkuara nga debitori. Nënshkrimi nga palët në marrëdhënie detyimore nuk paraqet vetëm një formalitet, por një veprim i tillë nënkupton pranimin e punëve të kryera nga kreditori dhe pohimin se ekziston borxhi ndaj kreditorit sipas faturave.

Pretendimi ankimor i kreditorit se gjykata ka bërë shkelje të dispozitave kur ka vendosur mbi mospranimin e faturave nga ana e debitorit pa e vërtetuar pamundësinë e pranimin andaj dispozitat ligjore e lejojnë përmbartimin edhe pa nënshkrimin e debitorit. Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë një pretendim të tillë nuk mund ta pranoj si të bazuar, ngase sipas dispozitave të lartcekura fatura duhet të jenë të nënshkuar. Në rastin konkret faturat nuk janë të nënshkuara nga ana e debitorit dhe si të tilla nuk mund të pranohen si dokumente të besueshme, në bazë të cilave mund të zhvillohet procedura përmbartimore, mirëpo kreditori mund të inicioj procedurë tjetër gjyqësore lidhur me realizimin e kërkesës së tij, varësisht nga suksesi në atë procedurë. Nga të cekurat kjo gjykatë vlerësoj se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet vërtetuar dhe të refuzohet ankesa e kreditorit si e pathemeltë.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika b), të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e shkallës së dytë

K.DH.Shk.nr.100/23, me datë 22.06.2023

Gjyqtarja,
Franciska Zhitija Ymeri